



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E APELIT
D U R R Ë S

N J O F T I M

**Për fillimin e procedurës së konkurimit për emërimin në pozicionin
e Sekretar pranë prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Durrës**

Bazuar, në ligjin Nr 97/2016 datë 06.10.2016 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, Aktet Normative të Prokurorit Përgjithshëm, Strukturën organike të kësaj prokurorie, ndryshuar me Urdherin e Prokurorit Përgjithshëm Nr 27 datë 21.02.2019, Prokuroria e Apelit Durrës ;;

N J O F T O N se :

1. Ka filluar procedura për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **Sekretar** pranë prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Durrës .

2. Bazuar në nenin 74, 75, dhe 76 të ligjit Nr 97/2016 datë 06.10.2016 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, kandidatët e interesuar për konkurim përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në shërbimin civil duhet të plotësojnë edhe kriteret e vecanta, të jetë diplomuar Jurist si dhe të ketë të paktën një vit praktikë profesionale ose cdo aktivitet që lidhet me prokurorinë.

3. Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit të paraqitet në sekretarinë e Prokurorisë Apelit Durrës, me adresë Lagja Nr 14, Shkozet Durrës.

4. Dokumentacioni nga ana e kadidatëve të paraqitet brenda datës 20.03.2019.

PROKURORIA E APELIT DURRËS

